



Universiteti Bujqësor i Tiranës



Këshilli i Qarkut Gjirokastrë

Nr. 1132 Prot. dt. 08/04/2024

Nr. 300 Prot. dt. 08/04/2024

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot më datë 08/04/2024, ndërmjet **Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT)** përfaqësuar nga **Rektori, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku**, dhe **Këshilli i Qarkut Gjirokastrë**, përfaqësuar nga **Kryetari, z. Dino Selimi**. Nisur nga qëllimi për të forcuar dhe thelluar marrëdhëniet ndërmjet dy institucioneve, bien dakord si më poshtë:

### Neni 1

#### Baza Ligjore

Kjo marrëveshje mbështetet në nenin 3 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe neni 2 pika 6 e Statutit të UBT, VKM nr. 188, datë 13.3.2019, "Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre" dhe Ligjin Nr 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", kreu III, Neni 8 dhe 9.

### Neni 2

#### Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) dhe Këshillit të Qarkut Gjirokastrë në fushën e bujqësisë, mjedisit, blegtorisë, akuakulturës, teknologjive ushqimore, agroturizmit, pylltarisë, si dhe ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të mjedisit, tokës bujqësore, pyjeve dhe liqeneve.

Secili institucion do të caktojë një person përgjegjës për bashkëpunimin, i cili do të referojë tek autoritetet drejtuese kompetente aktivitetet e bashkëpunimit.

### **Neni 3**

#### **Angazhimet e palëve**

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë angazhohet në përfshirjen e ekspertëve të Universitetit Bujqësor të Tiranës, në përputhje me nevojat e saj në të gjitha fushat e bashkëpunimit me interes reciprok.

Me qëllim që të arrihen objektivat e sipërpërmendura, të dyja institucionet angazhohen të sigurojnë mjetet e nevojshme, sipas normave në fuqi. Shpenzimet, e identifikuarat me mirëkuptim, do të mbulohen nga buxheti i institucioneve të përfshira në këtë marrëveshje ose edhe nga burime të tjera.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja**

Kjo marrëveshje do të ketë një kohëzgjatje prej **4 (katër) vjetësh** nga data e nënshkrimit nga ana e drejtuesve të dy Institucioneve.

### **Neni 5**

#### **Përgjegjësitë e Palëve**

1. **Këshilli i Qarkut Gjirokastrë** angazhohet që do të kontraktojë **Universitetin Bujqësor të Tiranës**, në kryerjen e shërbimeve të mëposhtme:

- Kryerjen e studimeve për rajonizimin e kulturave bujqësore në Qarkun e Gjirokastrës,
- Praktikat më të mira në përdorimin e tokës bujqësore dhe orientimi drejt bujqësisë organike dhe konsolidimit të kulturave bujqësore,
- Praktikat më të mira në përdorimin e tokës bujqësore me qëllim reduktimin e erozionit dhe rreziqeve të tjera mjedisore,
- Vlerësimi i gjendjes së rrjetit kullues dhe skemave të vaditjes dhe vënia e tij në efikasitet plotë,
- Monitorimi i cilësisë së ujrave në Qarkun e Gjirokastrës,
- Studime për praktikat më të mira bujqësore, miqësore me mjedisin që sigurojnë prodhim të qëndrueshëm,
- Hartimin e planeve të rehabilitimit të sipërfaqeve të djegura ose djerrë,

- Mbështetje për hapjen e shkollës profesionale për specialistët në fushën e bujqësisë,
- Hartimi i projektit për rehabilitimin e kanaleve vaditëse dhe rezervuareve ujitës në Qarkun e Gjirokastrës,
- Hartimi i projektit për rehabilitimin mjedisor të kabanoneve industriale në pjesën veriore të qytetit dhe kthimin e tyre në zonë shërbimesh ose rezidenciale,
- Hartimi i planit për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave në territorin e Qarkut të Gjirokastrës,

UBT ka detyrimin që të angazhojë specialistët më të mirë të fushës dhe të sigurojë produkte apo shërbime sipas nevojave që ka Këshilli i Qarkut të Gjirokastrës. Po kështu, UBT angazhohet të organizojë trajnime, seminare dhe workshope të përbashkëta që lidhen me zhvillimin e qëndrueshem të bujqësisë, agroturizmit, pylltarisë etj.

## **Neni 6**

### **Veprimtaritë e përbashkëta**

Palët do të bashkërendojnë përpjekjet e tyre për hartimin e projekteve dhe studimeve në fushat e lartpërmendura me qëllim sigurimin e mbështetjes financiare nëpërmjet aplikimit të projekteve tek donatorë të ndryshëm.

Fakultetet e UBT dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë angazhohen të koordinojnë aktivitetet që lidhen me zhvillimin e bujqësisë dhe mjedisit në territorin e njësisë vendore.

## **Neni 7**

### **Shkëmbimi i Informacionit**

UBT dhe Këshilli i Qarkut Gjirokastrë sigurojnë dhe shpërndajnë informacion me synim rritjen e vlerës së përdorimit të njësive agroturistike në Qarkun e Gjirokastrës.

## **Neni 8**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve, do të zgjidhen në frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

## Neni 9

### Dispozita të fundit

Marrëveshja hartohet në 2 kopje, dhe mund të rinovohet vetëm me dakordësinë e të dyja palëve. Ndryshimet, përmirësimet ose anulimi i kësaj marrëveshjeje bëhet me pëlqimin e të dy palëve duke njoftuar paraprakisht me shkrim jo më pak se 2 muaj përpara.

**Universiteti Bujqësor i Tiranës**

**Rektori**

**Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU**



**Këshilli i Qarkut Gjirokastrë**

**Kryetari**

**Dino SELIMI**

